



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Tiranë, më 02.09.2024

NJOFTIM PËR KUMTESA DHE PROJEKTE QË TRAJTOJNË NGJARJE TË
LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Të nderuar mësues, drejtues dhe specialistë të arsimit parauniversitar,

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1292/2, datë 16.04.2024, “Për miratimin e kalendarit të integruar të veprimtarive” të Komisionit Shtetëror për Organizimin e Veprimtarive në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit, si dhe në kalendarin e detajuar të aktiviteteve që janë miratuar për t’u realizuar nga Ministria e Arsimit të Sportit, Ju bëjmë me dije se Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), do të organizojë një simpozium me tematikë “*Ngjarje nga Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare në kurrikulën dhe në tekstet shkollore të arsimit parauniversitar*”.

Nëpërmjet këtij simpoziumi synojmë të mundësojmë ndarjen e ideve, kërkimeve, analizave, interpretimeve, hipotezave, projekteve kurrikulare dhe ndërkurrikulare etj., mbi ngjarje dhe aspekte të ndryshme nga Lufta Antifashiste Nacional- Çlirimtare.

ASCAP fton të gjithë të interesuarit (*mësues; drejtues të rrjeteve profesionale të historisë, gjeografisë, qytetarisë, gjuhës shqipe dhe letërsisë, arteve; drejtues të institucioneve arsimore; specialistë të ZVAP-ve dhe DRAP-eve etj.*), të aplikojnë për t’u përfaqësuar në këtë simpozium me kumtesa ose me projekte që kanë zhvilluar me nxënësit e tyre.

Disa çështje që mund të trajtohen në këtë simpozium nëpërmjet kumtesave ose projekteve, janë:

- Ngjarjet kryesore të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare (LANÇ).
- Figurat historike dhe roli i tyre në LANÇ.
- Përfshirja e popullsisë civile, roli i grave, i të rinjve dhe i fëmijëve në LANÇ.

- Marrëdhëniet e Shqipërisë me Fuqitë e Mëdha dhe me lëvizjet e tjera antifashiste në Evropë.
- Trashëgimia dhe pasojat pas Luftës së Dytë Botërore.
- Shqiptarët e Kosovës dhe të Çamërisë në vitet e Luftës së Dytë Botërore.
- Minoritetet gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore.
- Shqiptarët dhe hebrenjtë në vitet e Luftës së Dytë Botërore.
- Arsimi gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore.
- Arsimi, arti dhe letërsia gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore.
- Jeta e shqiptarëve gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore.
- LANÇ nëpërmjet filmave, këngëve partizane, veprave artistike.
- Instituti për Studimet Shqiptare gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore.
- Aspekte të LANÇ-it dhe të Luftës së Dytë Botërore në kurrikulën dhe në tekstet shkollore.

Procesi i aplikimit dhe i pranimit të kumtesave dhe të projekteve kurrikulare ose ndërkurrikulare

Të interesuarit do të dorëzojnë një draft të kumtesës dhe të projektit deri më datë **07.10.2024**, në formë elektronike në adresën: sekretaria@ascap.edu.al, shoqëruar me numrin personal të celularit.

Pas shqyrtimit të draftit të kumtesës ose të projektit nga komisioni i ngritur në ASCAP, ju do të njoftoheni përmes email-it tuaj për pranimin e kumtesës ose të projektit dhe vazhdimin më tej të përgatitjes së prezantimit, si dhe dorëzimin e prezantimit (PPT), brenda datës **28.10.2024** në adresën: sekretaria@ascap.edu.al.

Bazuar në udhëzimin e MAS-it, nr.16, datë 22.07.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, specialistët, mësuesit dhe drejtuesit që do të mbajnë kumtesa dhe që do të marrin pjesë në simpozium, do të vlerësohen me kredite.

Formati i kumtesës

Titulli i kumtesës: Emri dhe mbiemri i autorit/autorëve: Abstrakti: Fjalët kyç: Hyrja: Shtjellimi i çështjeve kryesore të kumtesës:
--

Konkluzione/diskutime:

Bibliografia:

Kritere për përgatitjen e kumtesave

- Numri i faqeve të kumtesës të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 8 faqe.
- Kumtesa të jetë e shoqëruar me një abstrakt 200-250 fjalë.
- Referencat përgjatë kumtesës të vendosen me numra dhe në fund të faqes të vendoset referenca e plotë me shkrim 10, Times New Roman.
- Në fund të kumtesës duhet të vendoset bibliografia sipas stilit *APA*.
- Kumtesa duhet të jetë e redaktuar nga ana gjuhësore dhe në respektim të gjuhës shqipe standarde.
- Formati të jetë A4, shkrim 12, Times New Roman, pa hapësirë midis rreshtave.

Formati i prezantimit të projektit në simpozium

Hyrja

- Prezantimi i temës së projektit dhe i qëllimeve të tij. (*Tema e projektit duhet të jetë e lidhur me ngjarje dhe aspekte të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare.*)
- Prezantimi i grupit të punës që ka punuar me projektin, si dhe bashkëpunëtorët.

Zhvillimi

- Përshkrimi i shkurtër i rëndësisë së temës së projektit (për nxënësit dhe/ose shkollën dhe/ose komunitetin).
- Prezantimi i përfituesve të projektit.
- Prezantimi i metodologjisë së përdorur për të përmbushur qëllimet (p.sh., metodat dhe mjetet e hulumtimit, instrumentet, mbledhja dhe analiza e të dhënave etj.).
- Evidentimi i veprimtarive kryesore të projektit.
- Përshkrimi për përdorimin e TIK-ut në projekt.
- Përshkrimi i produktit të projektit.

Mbyllja

- Shpjegimi për qëndrueshmërinë e projektit.
- Falënderimi për vëmendjen dhe interesin.

Koha e prezantimit të kumtesës ose të projektit është 10-15 minuta.